



Në bazë të nenit 7, alinea 9 të Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07, 5/09, 43/14 dhe 193/15), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 1 / 2016

për dorëzimin e kërkesave për pagesën të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në peshkari dhe akuakulturë për vitin 2016

I. LËNDA E SHPALLJES

Lënda e kësaj shpallje është ndarja e përkrahjes financiare për nënpikat nga masat në vijim:

Masa1	Përkrahja financiare në peshkari	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme
Nënpika 1.6	Mbrojtje plotësuese të peshqve në ujërat për peshkim	<ul style="list-style-type: none"> - Deri më 300.000,00 denarë për mbrojtje të pellgjeve peshkuese dhe zonat rekreuese - Deri më 150.000 denarë për mbrojtje të zonave peshkuese - Deri më 400.000 denarë për mbrojtje të rajoneve peshkuese

Masa2	Përkrahja financiare në akuakulturë	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme
Nënpika 2.2	Përkrahja financiare për material peshkim	<ul style="list-style-type: none"> - Deri më 300.000,00 denarë për shfrytëzues - 40% e vlerës së të vegjëlve të furnizuar
Nënpika 2.3	Përkrahje financiare për peshkun e prodhuar dhe të shitur në treg	- 20,00 denarë /kg

I. TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve sipas nënpikave kanë:

Subjektet	Nënpika
<ul style="list-style-type: none"> • Koncesionerët e peshqve nga ujërat për peshkim. Një koncesioner mund të shfrytëzojë mjete vetëm për një periudhë të caktuar për shumim natyral dhe ndalesë për peshkim 	1.6
<ul style="list-style-type: none"> • Subjektet të cilat posedojnë leje për prodhimin e materialit për peshkim nga baseni i peshqve i dedikuar për shitje dhe që nuk kanë importuar material për peshkim dhe peshq të gjallë gjatë periudhës dhjetor 2015 – dhjetor 2016 për shumim të basenit personal tme peshq • Për të vegjlit e furnizuar subjektet të cilat janë të regjistruara për veprimtari akuakulturë dhe janë të regjistruar në regjistër të ruajtësve të peshqve që është në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe kanë blerë të vegjlit nga subjektet që posedojnë leje për prodhim të materialit për peshkim nga basene të dedikuara për shitje 	2.2
<ul style="list-style-type: none"> • Subjektet të cilat janë të regjistruara për veprimtari akuakulturë dhe janë të regjistruar në regjistër të ruajtësve të peshqve që është në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave dhe nuk kanë importuar material për peshkim dhe peshk të gjallë në periudhën Dhjetor 2015- Dhjetor 2016. 	2.3

II. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mjetet nga nënpika 1.6 janë dedikuar për kompensim të shpenzimeve të pranueshme për mbrojtje plotësuese fizike të peshqve e cila bëhet në periudhën për shumim natyral të peshkut e vërtetuar në bazën peshkuese dhe vendimin e pruar për ndalesë për peshkim në ujëra ndaras për peshkim për periudhën prej 1 nëntori 2015 deri më 30 shtator 2016 edhe atë për shpenzime të bëra për:

- shërbime të personave të tretë (ruajtës të peshqve) për mbrojtje fizike në lartësi jo më shumë se rrogë mesatare bruto në veprimtarinë për person të angazhuar
 - lëndë djegse për objekte lundrimi në pronësi të koncesionerit apo të dhënë në shfrytëzim koncesionerit
 - lëndë djegse për automjete në pronësi apo të dhënë në shfrytëzim koncesionerit
 - huazim të objekteve për lundrim nga persona të tretë
- Mjetet nga nënpika 2.2 dedikohen për furnizim për materialin për peshkim.
Mjetet nga nënpika 2.3 janë të dedikuara për peshk të prodhuar dhe të shitur në periudhën prej 1 nëntor 2015 deri më 31 tetor 2016
Mjetet nga nënpika 2.3 paguhet në mënyrë të shkallëzuar edhe atë:
- për kilogram peshk të prodhuar dhe shitur në basen të peshqve deri më 25 000 kilogram - 100 % prej 20,00 denarë,
 - për kilogram peshk të prodhuar dhe shitur prej 25 000 deri më 50 000 kilogram - 75 % prej 20,00 denarë

- për kilogram peshk të prodhuar dhe shitur në basen të peshqve prej 50 000 deri më 100 000 kilogram - 50 % prej 20,00 denarë dhe
 - për kilogram peshk të prodhuar dhe shitur në basen të peshqve mbi 100 000 kilogram prodhim 25 % prej 20,00 denarë.
- Shuma e vlerës të mbështetjes për kilogram peshk i prodhuar dhe i shitur do të jetë 20,00 denarë për kilogram

III. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat për nënpikën e veçantë dorëzohen në origjinal.
Kushtet të cilat dihet ti plotësojnë kërkesit të mjeteve janë përcaktuar në Programin për përkrahje financiare në peshkari dhe akuakulturë për vitin 2016 ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 5/2016).

Nëse në Agjenci dorëzohen më shumë kërkesa sesa ka mjete në disponim në pajtim me Programin për përkrahje financiare në peshkari dhe akuakulturë për vitin 2016, Agjencia do tu japë përparësi atyre kërkesave që kanë dorëzuar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.

IV. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesë për pagesë" së bashku me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhëzimin e shfrytëzuesve mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk
Formularët e lartpërmendur mund të merren dhe drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 8:30 deri në ora 16:30 në adresën:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20
(ndërtesa e Makedonija Tabak bloku C)
1000 Shkup**

V. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në peshkari dhe akuakulturë për vitin 2016 së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 01/2016 dhe shënimin e shifrës së nënpikës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë.

Nëse zarfi nuk është shënuar siç duhet, Agjencia nuk merr përgjegjësi për arritjen jo në kohë ose të pakompletuar, po hapjen e parakohshme të kërkesës.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave për pagim :

1. Për Nënpikën 1.6

-për kryerjen e Mbrojtje plotësuese fizike të peshqve në periudhë prej 1 nëntori deri 20 mars të vitit 2015, afati fundit është **04 prill të vitit 2016**

- për kryerjen e Mbrojtje plotësuese fizike të peshqve në periudhë prej 1 prill deri 15 korrik të vitit 2015, afati fundit është **29 korrik të vitit 2016**

2. Për Nënpikën 2.2

- për material peshkimi në periudhë prej 01 shkurt deri 31 maj, afati fundit është 15 qershor të vitit 2016

-për material peshkimi në periudhë prej 01 korrik deri 30 shtator, afati fundit është **14 tetor të vitit 2016**

3.Për nënpikën 2.3

- për peshkun e prodhuar dhe të shitur në periudhën prej 1 nëntori të vitit 2015 deri 31 janar të vitit 2016, afati fundit është **15 mars të vitit 2016**

- për peshkun e prodhuar dhe të shitur në periudhën prej 1 shkurti të vitit 2015 deri 30 prill të vitit 2016, afati i fundit është **16 maj të vitit 2016**

- për peshkun e prodhuar dhe të shitur në periudhën prej 01 maj të vitit 2016 deri 31 korrik të vitit 2016, afati i fundit është **15 gusht të vitit 2016.**

- për peshkun e prodhuar dhe të shitur në periudhën prej 01 gusht të vitit 2016 deri 31 tetor të vitit 2016, afati i fundit është **15 nëntor të vitit 2016.**

Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren në shqyrtim.

Informata më të detajuara në kontakt telefonin (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresë: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk ose www.pa.gov.mk

Kontakt:

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për miratimin e pagesës.

Telefoni: **02 3097 - 460**, çdo ditë pune prej 08:30 deri në ora 16:30.

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk

